



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË
DREJTAT E NJERIUT

Tiranë, më 08.07.2019

RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN
“PËR ASISTENCËN SOCIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi në mbledhjen e datës 08.07.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”,

Në mbledhjet e Komisionit për të paraqitur dhe mbrojtur projektligjin, si dhe për të dhënë shpjegime ishin të pranishëm, përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Komisioni e shqyrtoi këtë projektligj në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Nga analiza e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës dhe përmbajtjes konkrete të këtij projektligji, rezulton se fusha që rregullon ky projektligj nuk përfshihet në çështjet që trajton kjo dispozitë kushtetuese, e për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ

Ky projektligj ka për qëllim të rregullojë mënyrën e dhënies së ndihmës ekonomike, të pagesave të aftësisë së kufizuar dhe bonusit të bebeve, për të garantuar mbrojtje sociale për të gjithë qytetarët. Gjithashtu, projektligji garanton mbështetje për familjet dhe individët në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara social ekonomike.

Objektivat që synohen të arrihen në lidhje me programin e ndihmës ekonomike, kanë të bëjnë me:

- i. administrimin dhe funksionimin e një skeme të përmirësuar të ndihmës ekonomike;
- ii. thjeshtimin e procedurave të panevojshme, për shkak të riorganizimit të skemës, të cilat janë bërë pengesë për mospërfitimin në kohë të ndihmës ekonomike;
- iii. nxitjen e punësimit dhe përfshirjen e personave në moshë aktive pune, përfitues të ndihmës ekonomike, në programet aktive të punësimit dhe formimit profesional;
- iv. mosrefuzimin e ofertave të përshtatshme të punës nga zyrat e punës;
- v. forcimin e masave shtrënguese në rastet e refuzimit apo largimit nga puna, me synimin për të shmangur sigurimin e të ardhurave në mënyrë alternative (informale);
- vi. përjashtimin nga detyrimi i paraqitjes në zyrat e punës për t'u regjistruar si punëkërkuar të papunë të anëtarëve të familjeve në zonat rurale, që zotërojnë ose jo tokë bujqësore në pronësi/përdorim, apo familjeve që kanë anëtarë në moshë aktive pune, që ndjekin arsimin e mesëm apo të lartë, por jo më shumë se deri në moshën 25 vjeç;
- vii. menaxhim dhe kontroll më të mirë mbi përdorimin e fondeve të ndihmës ekonomike dhe shmangien e abuzivitetit.

Objektivat që synohen të arrihen në lidhje me programin e aftësisë së kufizuar, kanë të bëjnë me:

- i. përcaktimin e së drejtës së përfitimit të pagesave të personave me aftësi të kufizuar dhe të së drejtës së përfitimit të një ndihmësi personal;
- ii. trajtimin e barabartë të të gjitha grupeve të aftësisë së kufizuar;
- iii. thjeshtimin e procedurave të panevojshme për përfitimin e pagesave të aftësisë së kufizuar (heqjen e vendimmarrjes së këshillit bashkiak), dhe dhënien e këtij përfitimi bazuar në vendimin e autoritetit përgjegjës për përcaktimin e kësaj të drejte (komisionit të vlerësimit).

Objektivat që synohen të arrihen në lidhje me bonusin e bebeve (ndihma e menjëherëshme financiare për foshnjat e porsalindura), kanë të bëjnë me:

- i. krijimin e një politike të re sociale pro lindshmërisë;
- ii. ofrimin e një ndihme të drejtpërdrejtë për të përkrahur lindjen e fëmijës;
- iii. dhënien e bonuseve të shumëfishuara për fëmijët e lindur

III. RIFORMULIMET SIPAS NENEVE

Neni 4

1. Neni 4 “Parime të përgjithshme”, sugjerohet të bëhet Neni 5 i projektligjit dhe Neni 5 të bëhet Neni 4.

Neni 5

1. Skronja “ë” e Nenit 5 sugjerohet të shtohet fjala “individëve” para fjalës “familjeve”

Neni 7

1. Titulli i nenit 7 sugjerohet të ndryshohet në “**Përfituesit e ndihmës ekonomike**”, duke hequr termin “subjekte”.

Neni 8

1. Titulli i nenit 8 sugjerohet të ndryshohet në “**Përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuar**”, duke hequr termin “subjektet”.

Neni 9

1 Titulli i nenit 9 sugjerohet të ndryshohet në “**Përfituesit e ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi i bebes)**”, duke hequr termin “subjektet”.

Neni 10

1.Nga titulli i nenit 10 sugjerohet të hiqet termi “subjekte”, riformulimi si vijon: **Përfituesit e ndihmës personal.**

Neni 11

1. Në titullin e nenit 11 termi “subjekte” sugjerohet të zëvendësohet me termin “personat”, riformulimi si vijon: **Personat jopërfitues.**

2. Pika “c)” e nenit 11 sugjerohet të riformulohet si vijon:

“shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët kanë nevojë për ndihmë emergjente, si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe e luftërave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Neni 12

1.Pika 1 e nenit 12 sugjerohet të riformulohet si vijon:

“1. Ndihma ekonomike është një pagesë mujore në lekë, për kategoritë e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji. Kufizimi në kohë i ndihmës ekonomike bëhet sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Koment: *Sugjerohet të hiqet pjesa që përcakton se ndihma ekonomike është një pagesë “që jepet në formën e një shpërblimi”. Ndihma ekonomike nuk është shpërblim, por ndihmë për shkak të pamundësisë.*

2. Pika 2 e nenit 12 sugjerohet riformulimi si vijon:

“Ndihma ekonomike, që përfitojnë familjet dhe individët në nevojë sipas formulës unike të pikëzimit, është e plotë dhe masa nuk kufizohet për shkak të numrit të anëtarëve. Ndihmë ekonomike përfitojnë familjet që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme nga programet e mbrojtjes shoqërore, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera, dhe individët e përcaktuar në nenin 7, të këtij ligji. “

3.Pika 3 e nenit 12 sugjerohet riformulimi si vijon:

“3. Familjet dhe individët në nevojë të përcaktuar sipas formulës unike të pikëzimit kanë të drejtë të marrin përfitime në natyrë. Mënyra e përfitimeve në natyrë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 16

1. Pika 2 e nenit 16 sugjerohet të riformulohet, duhe hequr paragrafin e dytë të pikës 2 për arsye se është përsëritje e panevojshme dhe jashtë kontekstit, e pikës 8 të nenit 12 ku përcaktohen procedurat dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike. Pra, nuk ka sens që paragrafi të përsëritet edhe në nenin 16 që përcakton rregullat për aplikimin e ndihmës ekonomike.

“2. Aplikimi për të përfutuar ndihmë ekonomike bëhet tek administratori shoqëror, në njësinë administrative, nën juridiksionin e së cilës ka vendbanimin.”

Koment: Pika 8 e Nenit 12 të projektligjit parashikon sa vijon: “8. *Procedura, dokumentacioni dhe masa mujore e përfitimit të ndihmës ekonomike përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Masa e ndihmës ekonomike, për familjet në nevojë, përcaktohet sipas strukturës së familjes.*” Pra, nuk ka sens që paragrafi të përsëritet edhe në nenin 16 që përcakton rregullat për aplikimin e ndihmës ekonomike.

2.Pika 3 e nenit 16 sugjerohet te riformulohet si vijon:

“Pranueshmëria në skemën e ndihmës ekonomike bëhet nëpërmjet formulës së unifikuar të pikëzimit, treguesit e së cilës mbajnë parasysh gjendjen e varfërisë. Treguesit e vlerësimit të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 20

1.Shkronja “b)” e pikes 4 te nenit 20 sugjerohet riformulimi si vijon:

b) Merr vendim sipas përcaktimeve të formulës unike të pikëzimit për caktimin e familjeve/individëve në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike, masën e përfitimit të tyre si

edhe refuzimin e kërkesës për dhënie e përfitimit të ndihmës ekonomike, të shoqëruar me arsyet e refuzimit;

Koment: *Nevojitet të përcaktohet qartë kriteri që përdor Shërbimi Social Shtetëror në lidhje me marrjen e vendimit për caktimin e familjeve/individëve në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike . Për këtë arsye, duhet shtuar pjesa “sipas përcaktimeve të formulës unike të pikëzimit”, me qëllim që shkronja “b)” e nenit 20 të jetë në harmoni me dispozitat e tjera të projektligjit.*

Neni 27

1. Sugjerohet riformulimi si vijon:

“Kontrolli për përdorimin e fondeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe mbështetjes financiare për foshnjat e porsalindura bëhet nga organet e specializuara të kontrollit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për auditimin e brendshëm në sektorin publik dhe legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.”

Neni 28

1. Per shkronjën a) te pikës 1 të nenit 28, sugjerohet riformulimi si vijon:

“a) përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative;”

2. Per shkronjen b të pikës 1 të nenit 28, sugjerohet riformulimi si vijon:

“b) ndëshkohen me masë disiplinore sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil ose Kodit të Punës.”

Neni 29

1. Pika 4 e nenit 29 sugjerohet riformulimi si vijon:

“4. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personi me aftësi të kufizuar, që pretendon se u është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzojnë të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”

Neni 32

1. Në pikën 1 të nenit 32 sugjerohet që Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9, pika 2; 12, pikat 1, 3, 4, 5 e 8; 13, pikat 1 e 2; 14; 15, pika 1, shkronja “b”; 16, pikat 2 e 3; 17, pika 1; 19, pikat 2 e 3; 20, pikat 2 e 3, shkronja “c”; 21; 30, shkronja “c”; dhe 31, pika 1, brenda 3 muajve.

2. Pika 2 e nenit 32 sugjerohet riformulimi si vijon:

“2. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet sociale që brenda 3 muajve të nxjerr udhëzimet në zbatim të neneve 12, pika 9, dhe 25, pika 1, të këtij ligji.”

3. Pika 3 e nenit 32 sugjerohet riformulimi si vijon:

“3. Ngarkohet ministri përgjegjës për gjendjen civile, ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe ministri përgjegjës për çështjet sociale për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët në zbatim të nenit 9, pika 3, të këtij ligji.”

Neni 33

1.Në nenin 33 sugjerohet që pas fjalisë së parë të shtohet fjalia si vijon: “Cdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.”

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

- a) **Në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) **Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm e miratoi atë, dhe u shpreh dakord për përcjelljen e raportit komisionit përgjegjës për shqyrtimin e projektligjit “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”,.

R E L A T O R

KRYETARI

KLOTILDA BUSHKA

ULSI MANJA